

Fillimi > -Kronikë

Konflikt në Mirditë/ 28-vjeçari kanos me armë dhe qëllon në ajër, bashkëfshatari i shkon në shtëpi dhe i kërcënon familijen

18 Shtator, 2022 12:36



Madhësia e tekstit: - +

MIRDITË

Zbardhet dhe dokumentohet ngjarja e ndodhur ditën e djeshme në Fan, Mirditë. Vihen në pranga të 2 shtetasit e përfshirë në konflikt.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisarariatit të Policisë Mirditë, pas marrjes së njoftimit për konfliktin e ndodhur ditën e djeshme, në fshatin Klos, Njësia Administrative Fan, Mirditë, ku shtetasi Glodian Gjoka dyshohet se pas një konflikti për motive të dobëta, me shtetasin Pashk Prenga ka qëlluar me armë zjarri, kanë vijuar veprimet hetimore intensive, me qëllim zbardhjen e plotë të rrethanave të ngjarjes.

Në përfundim të veprimeve hetimore janë arrestuar në flagrancë shtetasit Glodian Gjoka, 28 vjeç, banues në Mirditë dhe Pashk Prenga, 39 vjeç, banues në Mirditë, për veprat penale “Kanosja” dhe “Mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municioneve”.

Arrestimi i tyre është bërë pasi gjatë konfliktit për motive të dobëta, të ndodhur ditën e djeshme, shtetasi Glodian Gjoka dyshohet se ka qëlluar me armë zjarri për të kanosur shtetasin Pashk Prenga. Më pas, shtetasi Pashk Prenga dyshohet se ka shkuar në banesën e shtetasit Glodian Gjoka dhe ka kanosur familjarët e tij, me armë zjarri.

Vijon puna për gjetjen dhe sekuestrimin e armëve të zjarrit që posedonin 2 të arrestuarit. Materialet procedurale janë referuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, për veprime të mëtejshme.

Për t'u bërë pjesë e grupit "Balkanweb" mjafton të klikoni: Join Group dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. Grupi Balkanweb

Etiketa: Glodian Gjoka konflikt mirditë Pashk Prenga



Kerko ketu

LAJMET E FUNDIT



Konflikti Kinë-Tajvan, SHBA: Nëse do të ketë përshkallëzim, ndërhyrja e Fuqisë së Parë Botërore do të ishte e drejtpërdrejtë

19 Shtator, 2022




Tetë raketa ruse godasin termocentralin bërthamor në Ukrainë, nuk raportohet për vitkima

19 Shtator, 2022




Operacioni më i madh policor/ I jepet sot lamtumira Mbretëreshës Elizabeth II, mbi 10 000 oficerë në rrugët e Londrës

19 Shtator, 2022



U qëllua me breshëri plumbash, ja kush ishte shënjestra e atentatit në Shkodër, 30 gëzhoja në vendngjarje (EMRI)

19 Shtator, 2022



Rama, avokati i politikës filo ruse të Vuçiçit në Europë/ Berisha: Ky revolucion do të shpëtojë Shqipërinë nga rrokullisja

19 Shtator, 2022



Vrasja në Shkodër, gjendet arma dhe motoçikleta e djegur, policia në kërkim të autorëve

19 Shtator, 2022

NA NDIQNI NË RRJETET SOCIALE

@balkanweb




TË NGJASHME



Konflikti Armeni- Azerbajxhan, SHBA shpreh shqetësimin për pasojat te civilët


15 Shtator, 2022



Babai shkoi në litar në vend të të birit por.../ Historia e dhimbshme e masakrës së Qafë Valmirit. Dosja: Nuk mund të gjejmë prova që janë takuar në male, mjafton...

Fatmira Nikolli | 29 Gusht, 2022

TË FUNDIT NGA -KRONIKË



U qëllua me breshëri plumbash, ja kush ishte shënjestra e atentatit në Shkodër, 30 gëzhoja në vendngjarje (EMRI)

19 Shtator, 2022




Vrasja në Shkodër, gjendet arma dhe motoçikleta e djegur, policia në kërkim të autorëve

19 Shtator, 2022



Vrasja në Shkodër/ Autorët kanë lëvizur me motoçikletë, viktima dyshohet se...(VIDEO)

19 Shtator, 2022



VIDEO/ Si ndodhi vrasja e 19-vjeçarit në Shkodër, disa persona iu afruan të riut në lokal dhe qëlluan me breshëri plumbash (DETAJE)

19 Shtator, 2022



Rama i bën thirrje të rinjve të qëndrojnë në vendin e tyre, The Telegraph: Rreth 2 mijë njerëz në veri të Francës janë gati të rrezikojnë jetën për të hyrë në Britani


18 Shtator, 2022



Vrasja e 19-vjeçarit në Shkodër, Artan Hoxha: One shot, one kill! Me mjekrat, si po shkon brisku?


18 Shtator, 2022

KATEGORIA VIDEO




U qëllua me breshëri plumbash, ja kush ishte shënjestra e atentatit në Shkodër, 30 gëzhoja në vendngjarje (EMRI)

19 Shtator, 2022




Rama, avokati i politikës filo ruse të Vuçiçit në Europë/ Berisha: Ky revolucion do të shpëtojë Shqipërinë nga rrokullisja

19 Shtator, 2022



Vrasja në Shkodër/ Autorët kanë lëvizur me motoçikletë, viktima dyshohet se...(VIDEO)

19 Shtator, 2022



VIDEO/ Si ndodhi vrasja e 19-vjeçarit në Shkodër, disa persona iu afruan të riut në lokal dhe qëlluan me breshëri plumbash (DETAJE)

19 Shtator, 2022



VIDEO/ Napoli "mbretëron" në San Siro, ekipi i Spalletit mund kampionët e Italisë

18 Shtator, 2022



Atentati në Shkodër, momenti kur trupi i 19-vjeçarit transportohet drejt morgut me ambulancë (VIDEO)

18 Shtator, 2022

